

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Have Halilti, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit F.L., nga Prishtina, për shkak të veprës penale krimi i luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 30 të LPJ, gjegjësisht krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës, nga neni 120 par.1 dhe par.2 nën par.1. lidhur me nenin 129 par.1 nën par.1 dhe 2 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.154/16, të dt.09.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 30.10.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.154/16, të dt.09.03.2018, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.154/16, të dt.09.03.2018, i akuzuari F.L., nga Prishtina, është liruar nga akuza për veprën penale krimi i luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 30 të LPJ, gjegjësisht krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës, nga neni 120 par.1 dhe par.2 nën par.1. lidhur me nenin 129 par.1 nën par.1 dhe 2 të KPK, për shkak se nuk është provuar se ka kryer vepër penale.

Të dëmtuarit F.H. dhe N.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që të akuzuarin F.L., ta shpall fajtor për veprën e kryer penale dhe ta dënoj sipas ligjit, apo lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe

vendim.

-Përgjigje në ankesë e PSRK, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit F.L., av.T.RR., me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzon në tërësi si të pa bazuar ankesën e PSRK, të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/I.nr.195/18, të dt.07.05.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PSRK, dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari F.L., të shpallet fajtor dhe të dënohet për veprën për të cilën është akuzuar apo aktgjykimi të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim dhe vendim, kurse përgjigja në ankesën e prokurorit të PS, e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit Av.T.RR., të refuzohet si e pabazuar, meqë nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si në përgjigje të ankesës.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, në këtë çështje penale nuk caktoi seancën e kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues dhe mbajtja e seancës së kolegjit nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar pretendimet ankimore të PSRK, dhe të përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit F.L., av.T.RR., edhe sipas detyrës zyrtare, e bashkë me të edhe aktgjykimin e ankimuar, e duke marr parasysh edhe mendimin me shkrim të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesat e PRSK në Prishtinë është e pa bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PSRK-së në Prishtinë, në ankesën e saj pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, përshkruan radhitjen e ngjarjes në ankesë, si dhe komunikatën se: Me 01 Nëntor të vitit 1998, në gazetën "Koha Ditore", është komunikuar komunikata me përmbajtje si në vijim Kumtesë nr.4, e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK, hetimet kryhen në burgun e hetuesisë nr.3, kumtesa me përmbajtje se janë arrestuar J.K. dhe C.D., dhe sektori i hetuesisë ka kryer hetimet në burgun e hetuesisë nr.3, dhe policia ushtarake e nën zonës operative të "...", me ddt.30.10.98, ka arrestuar J.K. nga fshati ... i kryetar i ... dega në ... dhe C.D. nga fshati me banim në Sipas kumtesës drejtoria e shërbimit informativ të UÇK-së, njofton se me veprimtarinë e tyre kundër çlirimtareve të UÇK-së, J.K. dhe C.D., kanë propaganduar për dorëzimin e armëve në bashkëpunim me kolaboracionistes S.B., nga fshati ..., dhe R.H., nga ... të cilët kohë më parë janë ekzekutuar nga UÇK-ja, si dhe janë në koordinim të vazhdueshëm A.K., anëtar i kryesisë së "..", i cili në shërbimin informativ të UÇK-së, është njohur si zhvillues i luftës speciale kundër UÇK dhe një sanitar i një policie autonomistët e Kosovës. Kumtesa është lëshuar për hetimin e kryer në burgun hetues nr.3, Prishtinë, 01.11.1998, Drejtoria e Policisë Ushtarake të UÇK-së. Sipas ankesës gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe gjykata në aktgjykimin e saj, e liron të akuzuarin F.L., në mungesë të provave me pretendim se konstatimi i gjykatës se të ndjerit R.H. dhe S.B., nuk janë vranë nga pjesëtar të UÇK-së.

Sipas ankesës emblema dhe dilema se personat e maskuar kishin emblema të UÇK-së, apo të

policisë ushtarake, nuk mund të ketë fuqinë relevante dhe të konkludohet se nuk dihet nëse dy civil i kanë vrarë pjesëtar të UÇK, dëshmitarët okular H., I., E., E., dhe M.H., kanë deklaruar se personat me maska ishin nga UÇK, mirëpo, dëshmitë e tyre nuk përputhen vetëm me emblemat, gjë që është e kuptueshëm se kujtesa e tyre është e dobësuar. Gjykata anashkalon komunikatën e lëshuar të gazetës së asaj kohe që është lëshuar në emër të ashtuquajturës “Drejtoria e Policisë Ushtarake të UÇK-se”. Sipas ankesës pavarësisht se në atë kohë nuk ekzistonte “Drejtoria e Policisë Ushtarake të UÇK-se”. Është fakt se kjo komunikatë përmban një fakt të njohur botërisht për arrestimin e J.K.t dhe C.D.t, nga UÇK, e të cilët janë liruar. Duke u nisur nga komunikatat e J. e C. me arrestimin e S.H. e C. sipas ankesës del se prapa vrasjes së R.H. e S.H., qëndrojnë ushtarët e UÇK. Sipas ankesës kjo është si pasojë e pjesëmarrjes së delegacionit të fshatit “...” me forcat serbe, e duke marrë parasysh se S. është vrarë se në rrugë nga fshati “...” për në “...”, ai ka parë personat të cilët pastaj erdhën në fshatin “...” me maska dhe në shqyrtimin gjyqësor nuk është paraqitur asnjë motiv tjetër i mundshëm për vrasjen e tyre, në favor të përfundimit të tillë sipas ankesës është se edhe pohimi i të akuzuarit F.L., i cili në mbrojtjen e tij, ka deklaruar se nuk ka hetuar dhe nuk është raportuar për vrasjen e R. dhe S., pasi që për vrasjen e këtyre dy civilëve përgjegjësinë e ka marrë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

Sipas ankesës rezulton se brigada “..”, ishte më e organizuar për të luftuar për liri dhe i akuzuari F.L., shumë shpejtë është njoftuar për rrëmbimin e R.H., pasi djali i R., E., ishte nisur pas veturës në të cilën ishte babai i tij, me çrastë të vendi “...”, e ka takuar të akuzuarin F.L., i cili ka pasur radio lidhje të cilën nuk e konteston as i akuzuari. Gjykata nuk vlerëson faktin se menjëherë pas vrasjes i akuzuari F.L. i shoqëruar me S.H., kanë arritur në vendin e ngjarjes dhe i kanë parë kufomat e dy civilëve dhe pas saj të dy janë larguar në drejtim të fshatit “...”, pra në të njëjtin drejtim ku kanë shkuar dhe vrasësit e tani të ndjerëve R. e S., dhe nga kjo rrjedh se i akuzuari F.L., si një komandant nuk mori masa drejt zbulimit të kryesve. Sipas ankesës është vërtetuar se i akuzuari F.L., është emëruar komandant i brigadës “..” gjatë muajit gusht të vitit 1998, në zonën e përgjegjësisë civile, e në të cilën hynte edhe fshati “...”. Ky fakt është vërtetuar nga vetë i akuzuari dhe dëshmitarët R.S. dhe B.Z. Më tej ankesa thirret edhe në rastet e praktikës gjyqësore ndërkombëtare lidhur me ekzistimin e përgjegjësisë komanduese të rasteve të ICTY, kundër D.R., në rastin “...”, Gjykata Supreme e SHBA-së, në terme komandant ushtarak, në vendimin e konferencës diplomatike të përfaqësuesve të OKB për themelimin e gjykatës ndërkombëtare penale, të grupit punues të parimeve të përgjithshme të së drejtës penale, në Qershor të vitit 1998, ku qartësohet termi komandant ushtarak që përfshihen personat e forcave me kontroll të rregullta si krye komandant.

Ankesa thirret në mendimin e dhomave dhe në raste tjera që janë gjykuar nga drejtësia ndërkombëtare lidhur me përgjegjësinë komanduese të Tribunalit të Hagës dhe aktgjykimet e tribunalit për rastet të cilat janë paraqitur në ankesë të aktgjykimit të apelit, V., aktgjykimi i O. aktgjykimi i apelit për rastin “..”, aktgjykimi i apelit, për rastin M.,K. dhe Q., si dhe aktgjykimet tjera të ndërmarra nga dhomat e ICTY. Në vazhdim ankesa ka paraqitur rastet e aktgjytimeve të apelit, me nr.2016, 2017 dhe aktgjykimin gjyqësor të “O.”, me nr.... dhe bazuar në praktikën penale ndërkombëtare gjykata e shkallës së parë, ka nxjerr konkludim të gabuar se i akuzuari nuk ka pasur kontroll direkt se në rastin konkret dihet identiteti i kryesve të krimit dhe sipas ankesës prokuroria konsideron se përgjegjësia komanduese e të akuzuarit F.L., është e pa kontestueshme pasi që ai më parë si komandant brigade e cila ka përfshirë zonën e përgjegjësisë së fshatit ku ka ndodhur krimi, ka pasur njohuri për krimin dhe nuk ka ndërmarrë masa të nevojshme, për të parandaluar apo ndaluar vrasjen e R.H. dhe S., dhe me vetëdije nuk ka ndërmarrë masa rreth zbulimit të kryesve të këtij krimi pasi në nënin 1998, është emëruar drejtor i policisë ushtarake pranë shtabit të përgjithshëm, dhe rastin asnjëherë nuk është dorëzuar te rastet kompetente për hetime dhe ndjekje.

Gjykata e Apelit, edhe pse aktgjykimi nuk është ankimuar, sipas bazës ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sipas detyrës zyrtare, gjykata në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, aktgjykimin e vlerësoi edhe sipas kësaj baze ankimore dhe gjeti, se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota rreth argumentimit se i akuzuari F.L., nuk është kryes i veprës penale krimi i luftës kinder popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 30 të LPJ-së, krimet e luftës për shkelje të rëndë nga neni 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës nga neni 120 par. 1 dhe par.2 nën par.1 lidhur me nenin 129 par.1 nën par. 1 dhe 2 të KPK-së, dhe nga provat të cilat janë nxjerr në shqyrtimin gjyqësor e të cilat gjenden në shkresat e lëndës gjykata drejt ka vlerësuar se nuk është provuar me asnjë provë të vetme se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila ka qenë objekt i akuzës, dhe nuk ekziston asnjë fakt vendimtar, apo e provë e besueshme se i akuzuari F.L., si pjesëtar i UÇK-së, ka qenë komandant ushtarak i brigadës “..”, e sipas objektit të akuzës brigadës “..”, është formuar gjatë muajit gusht të vitit 1998, në të cilën zonë të përgjegjësisë civile, e në të cilën hynte edhe fshati .. me datën 02.10.1998 janë marrë, ndërjet R.H. nga fshati dhe S.B., nga fshati ... nga persona të pidentifikuar me një veturë Golf rreth orës 13,00 pas faljes së namazit të Xhamisë, e të cilët me vonë janë gjetur të vdekur dhe të ekzekutuar në hyrjen e fshatit ...

Në favor të përfundimit të këtyllë se i akuzuari F.L., me asnjë provë të besueshme nuk është vërtetuar se ka qenë komandant i brigadës “..” e më vonë edhe Drejtor i Drejtorisë së Policisë Ushtarake pran Shtabit të Përgjithshëm, e në mbështetje të kësaj janë edhe dëshmitë e dëshmitarëve R.S.,B.Z, A.S. dhe J.K. dhe të këta dëshmitarë vërtetojnë faktin se ka pas një ofensivë e forcave serbe gjatë verës së vitit 1998 dhe brigadat, batalionet dhe kompanitë ekzistuese janë dezintegruar dhe shumë pjesëtarë vullnetarë si ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) janë larguar kështu sipas vendimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës(UÇK-së) , është dashtë të bëhet strukturimi i Njësisve ushtarake për ti futur vullnetarët në brigada dhe ky proces, gjerë në formimin e komandës ushtarake të brigadës “..” ka zgjatë gjerë në fund të vitit 1998, ndërsa më vonë i akuzuari F.L. ka fundit i vitit 1998 është emëruar si Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ushtarake pran Shtabit të përgjithshëm, dhe gjykata lidhur me këto ka dhënë të qarta dhe të plota lidhur me përgjegjësinë komanduese dhe e bazon se , në atë kohë duke u mbështet në dëshmimit në dëshmitë e dëshmitarëve se brigada “..”dhe Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ushtarake janë formuar më vonë pas ekzekutimit R.H. dhe S.B. janë gjetur të vrarë me datën 02.10.1998 në fshatin .., nga kjo del konkludimi se me asnjë provë të besueshme nuk është vërtetuar përgjegjësia komanduese e të akuzuarit F.L., dhe i akuzuari F.L. në bazë të përgjegjësisë komanduese, e cila gjerë në kohën kur janë privuar nga jeta nga personat e panjohur të veshur me rroba të UÇK-së dhe me emblemat e UÇK-së i akuzuari F.L. nuk ka mund të dijë se a kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së, apo ndonjë formacioni tjetër kjo për faktin gjatë krijimit të brigadave batalioneve e të cilat botërisht dihet Ushtria Çlirimtare e Kosovës(UÇK-kë) është formuar në baza vullnetare e jo në bazë doktrinës së reduktimit të ushtarëve, që nënkupton edhe përzgjedhjen se kush do të jetë ushtarë, shumë lehtë në këto formacione, edhe pse nuk kanë qenë tërësisht e formuar brigada “..”si dhe brigada “..”, ndërsa Drejtorja e Policisë Ushtarake praj Shtabit të Përgjithshëm është formuar më vonë, shumë lehtë kanë mund të infiltrohen edhe grupet tjera e të cilat nuk kanë qenë komandën e askujt kjo për faktin se kemi formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-në) në baza vullnetare dhe pa regrutim të ushtarëve dhe regrutimi i ushtarëve bëhet në çdo ushtri mirëpo kjo nuk ka ndodhë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për faktin se për rrethanat e kohës për të cilat botërisht sot e kësaj dite dihen, për shkak të represionit të madhe të Ushtrisë, policisë, dhe forcave tjera paramilitare është ushtruar dhunë tej mase ndaj popullatës civile, e si pasojë e kësaj vet vetiu është imponuar formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), në baza vullnetare e cila gjatë krijimit të saj ka marrë edhe formatin e një ushtrie çlirimtare dhe të rregullt , e

për mbrojtjen e popullatës dhe gjykata ka dhënë arsye të qarta se në vend strehimit e fshatrave të Zonës Operative të "...", ku ka vepruar edhe brigada ".." dhe "..." e të cilat janë formuar për ti mbrojtje popullatën civile shkak të represionit të madhe të Ushtrisë, policisë, dhe forcave tjera paramilitare dhe qëllimi i formimit të brigadave ka qenë mbrojtja e popullatës civile.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet ankimore lidhur me botimet – komunikatën nr.4, e cila është botuar në shtypin e atëhershëm, ato kanë mundë të shfrytëzohet si informata dhe asnjë mënyrë nuk mundë të merren si prova se ajo komunikatë është leshtuar nga Shtabi i Përgjithshme i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila ka qenë e botuar në gazetate e asaj kohe, dhe sipas dëshmitarëve R.S., B.Z., A.S. dhe J.K., të gjithë kanë dëshmuar se Drejtoria e Policisë Ushtarake të UÇK-së gjer në atë kohë nuk ka qenë e formuar ajo është formuar pas vrasjes së personave të panjohur të ndjerëve R.H. dhe S.B. e të cilët janë gjetur të vdekur në hyrje të fshatit ..., e lidhur me këtë gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota se përgjegjësia komanduese sipas Konventave fare nuk bie në përgjegjësin e të akuzuarit F.L. kjo për faktin se gjer në momentin kur janë gjetur të vrarë personat e cekur më lartë, e që në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se fare nuk kanë qenë në anën e regjimit të atëhershëm serbë, i cili regjim ka ushtruar dhunë ndaj popullatës civile, të njëjtit janë vrarë nga personat të panjohur të cilët sot e asaj dite nuk dihen dhe nuk janë zbuluar.

Për më tepër katër persona të cilët kanë kryer vrasje e dy civile R.H. dhe S.B.t, se ata kanë pas emblema të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) të Policisë Ushtarake dhe kanë qenë të maskuar, e të cilët nuk janë identifikuar, se kush janë personat të cilët kanë kryer vrasjen, rrjedhimisht del fakti vendimtar se ata personat- kryesit e vrasjes së dy civilëve a kanë qenë pjesëtar të UÇK-së apo jo, dhe a kanë qenë në përgjegjësinë komanduese të brigadës "..", e ky fakt përjashton përgjegjësinë komanduese të akuzuarit F.L., e njëkohësisht përjashton edhe përgjegjësin se i njëjti ka qenë drejtor i Drejtorisë së Policisë Ushtarake, kjo për arsye se edhe brigada ".." bashkë me brigadën ".." si dhe Drejtoria e Policisë Ushtarake pran Shtabit të Përgjithshëm ku komandant ka qenë i akuzuari F.L., janë formuar më vonë, ndërsa dy civilët, të cilët R.H. dhe S.B. janë vrarë dhe janë gjetur të vrarë me datën 02.10.1998 në fshatin ..., dhe i akuzuari F.L., pas dy ditësh ka shkuar në ngushëllime në familjen e S.B. për ti shprehur ngushëllime e kjo tregon faktin se të dytë të vrarë civil të cekur më lartë, nuk kanë qenë bashkëpunëtorë të regjimit të atëhershëm i cili ka ushtruar dhunë ndaj popullatës civile. Pra nga kjo qartë del konkludimi se i akuzuari F.L., kishte me qenë përgjegjës po të kishte kontroll efektiv ndaj ushtarëve të tij, e të cilat brigada kanë qenë në formim e sipër, si dhe të ketë pas në kontrollin e tij, zonën e përgjegjësive komanduese që ai mund të kontrolloj veprimet e çdo ushtari vullnetar të asaj kohe, dhe edhe pse kanë qenë në formim e sipër brigadat nga shkresat e lëndës rezulton se personat civil të vrarë të cekur më lartë me asnjë provë të besueshme nuk është vërtetuar se a i takojnë brigadës ".." apo brigadës ".." për shkak të sulmit të atëhershëm të forcave të ushtrisë, policisë, dhe forcave tjera paramilitare ndaj popullatës civile e të cilat forca gjatë ofenzivës, në muajin korrik kanë djegur fshatrat, rreth akseve rrugore, K....., O....., R....., M....., dhe nga forcat serbe janë djegur të gjitha fshatrat nga, , , deri në, pra të gjitha fshatrat të cilat përfshijnë varg malet e ... dhe se në atë kohë është vrarë edhe komandant K.. Për më tepër edhe dëshmitarët- I.H., E.H., S.H., H.H., N.B. dhe N.M. dhe S.D. asnjëri prej tyre nuk vërtetojnë se në bazë të përgjegjësive komanduese i akuzuari F.L., nuk ka ndërmarr masa ndaj zbulimit të kryerësve në bazë të përgjegjësive komanduese ndaj ketër personave të maskuar e të cilët i kanë vra R.H. se S.B..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimi ankimor se rasti nuk është hetuar nga Drejtoria e Policisë Ushtarake pran Shtabit të Përgjithshëm, pas marrjes së detyrës nga i akuzuari F.L., dhe asnjëherë nuk është dorëzuar në organet, nuk qëndron, Drejtoria e Policisë Ushtarake pran Shtabit të Përgjithshëm është formuar më vonë në fund të vitit 1998, ndërsa dy civilët, R.H. dhe S.B. janë vrarë dhe

janë gjetur të vrarë me datën 02.10.1998 në fshatin K... , e kjo është para formimit të Drejtorisë së Policisë Ushtarake pran Shtabit të Përgjithshëm, për arsye se edhe po të ishte ashtu si pretendohet në ankesë, rasti ka qenë i njohur që prej fillimit edhe për misionet e drejtësisë të UNMIK-ut dhe të EULEX-it, të cilat kanë vepruar në Kosovë, edhe për organet e ndjekjes në Kosovë.

E nga kjo del se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe pse ankesa në këtë drejtim ka qenë e mangët, nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP.

Pretendimet ankimore se gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike është e pabazuar kjo për arsye se gjykata drejtë ka vepruar dhe drejtë ka vërtetuar se i akuzuari F.L., nuk është kryerës i veprës penale krimi i luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 30 të LPJ, gjegjësisht krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës, nga neni 120 par.1 dhe par.2 nën par.1. lidhur me nenin 129 par.1 nën par.1 dhe 2 të KPK-së, gjykata drejtë ka vërtetuar se nuk ka qenë në përgjegjësinë komanduese vrasja e dy civileve, R.H. dhe S.B. me datën 02.10.1998 të cilët janë marrë në fshatin ... nga katër persona të pidentifikuar të veshur dhe me emblema të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), me tesa të zeza, e të cilët më vonë janë gjetur vrarë në hyrje të fshatit Kravaseri. Gjkata në tërësi ka vërtetuar se pas sulmit të ushtrisë, policisë, dhe forcave tjera paramilitare ku është ushtruar dhunë ndaj popullatës civile, dhe janë djegur gjatë muajit Korrik të vitit 1988 të gjitha fshatrat nga ..., ..., ..., ..., deri në ..., pra të gjitha fshatrat të cilat përfshijnë varg malet e B... Gjkata në tërësi ka vërtetuar në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve R.S., B.Z., A.S. dhe J.K. edhe të gjithë të cilët kanë vërtetuar se ka pas një ofensivë e forcave serbe gjatë verës së vitit 1998 dhe brigadat, batalionet dhe kompanitë ekzistuese janë dezintegruar dhe shumë pjesëtarë vullnetarë si ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) janë larguar. Gjkata drejtë ka vërtetuar se sipas vendimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), është dashtë të bëhet strukturimi i Njësisë ushtarake për ti futur vullnetarët në brigada dhe ky proces gjerë në formimin e komandës ushtarake të brigadës “..” ka zgjatë gjerë në fund të vitit 1998. Drejtë është vërtetuar se më vonë i akuzuari F.L. ka fundit i vitit 1998 është emëruar si Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ushtarake pran Shtabit të Përgjithshëm, dhe gjykata drejtë ka vërtetuar se i akuzuari F.L. nuk ka pas përgjegjësi komanduese, dhe gjykata drejtë ka vërtetuar se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk ka lëshuar komunikata, nëse janë lëshuar ato janë lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm të (UÇK-së) ,dhe se paraprakisht është dashur të ketë pas aprovim paraprak nga Shtabi i Përgjithshëm, dhe gjykata drejtë ka vërtetuar se komunikata nr. 4 e botuar në gazetën “Koha Ditore“ e dt. 04.11.1998 nuk është lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm. Dhe drejtë është vërtetuar nga gjykata se i akuzuari F.L. ,nuk ka pas përgjegjësi komanduese, sepse nuk ka pas kontroll ndaj vartësve të tij– ushtarëve dhe nuk ka pas territor ku ka qenë përgjegjësia komanduese të tij për shkak të ofensivës të ushtrisë, policisë dhe forcave paramilitare të ushtruara ndaj popullatës civile , dhe në atë periudhë kohore me katër persona me emblema të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), e të maskuar i kanë marr dy persona civil në fshatin ... pas faljes së namazit në Xhaminë e fshatit dhe personat të pidentifikuar janë larguar në drejtim të panjohur dhe më vonë të ndjerit R.H. dhe S.B. janë gjetur të vrarë në hyrje të fshatit ..., dhe i akuzuari F.L. nuk ka pas përgjegjësi komanduese ndaj varësve të tij, dhe kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Sipas vlerësimit dhe qëndrimit të Gjykatë së Apelit, se është shkelur ligji penal në dobi të akuzuarit F.L., e në të cilën gjykata shikon edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 385 par 1 të KPP-së pretendimi i këtillë ankimor është i paqëndrueshëm dhe duke i vlerësuar provat e nxjerra në shqyrtim gjyqësor të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vlerësimin e tyre, në mënyrë të besueshme gjykata ka vërtetuar se, i akuzuari F.L. nuk është kryes i veprës penale krimi i luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 30 të LPJ, gjegjësisht krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës, nga neni 120 par.1 dhe par.2 nën par.1. lidhur me nenin 129 par.1 nën par.1 dhe 2 të KPK-së, dhe gjykata drejt ka vepruar me marrje të aktgjykimit lirues për të akuzuari F.L., gjykata drejt ka vepruar se të ndjerit R.H. dhe S.B., nuk janë vrarë si kolaboracionist përkundrazi ata i kanë ndihmuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe popullata civile dhe gjykata drejt ka aplikuar ligjin penal për arsye se me asnjë provë nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar, e në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP.

Prandaj, nga arsyet e përshkuara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet ndërsa ankesa e PRSK-së, të refuzohet si e pabazuar, ne bazë të nenit në bazë të nenit 401, në bazë të nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.206/2018, me dt.30.10.2018

Procesmbajtësi,

Sadik Kryeziu

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Hava Haliti

Kryetare e Kolegjit,

Tonka Berishaj

PAGE

PAGE 7